

Intervista në emisionin “Opinion” nga Blendi Fevziu, në TV Klan Komentet e ambasadorit Wollfarth

21 prill 2011

TV Klan: Ambasadori Wollfarth, është hera e parë që ambasadorët janë kaq aktivë në një fushatë zgjedhore. Pse pikërisht në këto zgjedhje?

Ambasadori Wollfarth: Sepse këto zgjedhje kanë rëndësi. Në tani jemi para zgjedhjeve vendore të 8 Majit dhe çështja qëndron te stabilizimi i kësaj demokracie ende të re. Demokracia në këtë vend ka një histori 20-vjeçare, me të përpjetat dhe të tatëpjetat e veta. Ne jemi të bashkuar për të ndihmuar shqiptarët që të gjejnë një rrugë edhe më të mirë për Shqipërinë në ndërtimin e demokracisë. Dhe kjo është edhe ajo që na bashkon. Pikësëpari, duke pasur prejardhje dhe formime të ndryshme, por duke qenë njëkohësisht të bashkuar, kemi një përfaqësues të një kombi të madh, model i një demokracie shumë të hershme, një përfaqësues të një organizate të madhe prej shumë kombesh, apo thënë ndryshe, një bashkim i shumë shteteve, Bashkimi Evropian, në të cilin Shqipëria aspirojnë të hyjë, dhe OSBE-në. Shqipëria ka ndërmarrë disa angazhime të qarta në lidhje me OSBE-në dhe Prezenca jonë në Shqipëri është këtu për t'i mbështetur shqiptarët për të gjetur rrugën më të mirë për t'i përmbushur këto angazhime sa më shpejt që të jetë e mundur.

TV Klan: Por Ambasador Wollfarth, pas deklaratave tuaja, jo vetëm deklaratat e bëra nga ambasadorët, por edhe nga Bashkimi Evropian, nga diplomatë të Departamentit të Shtetit, apo të tjerë, që të dyja palët në Shqipëri, si opozita ashtu edhe shumica mendojnë apo i interpretojnë ato si mbështetje secili për veten e vet. A mund të jeni më të qartë me mesazhet tuaja apo njerëzit i keqkuptojnë mesazhet tuaja këtu?

Ambasadori Wollfarth: Nuk besoj se ka keqkuptime. Përkundrazi. Në qoftë se ata gjejnë mbështetje në atë që ne bëjmë, kjo është gjë e mirë, sepse demokracia ka nevojë për alternativa. Ka nevojë për oferta të mira, ka nevojë për programe të mira e ka nevojë edhe për argumente të mira. Dhe në fakt, ka shumë prej këtyre në këtë fushatë të zgjedhjeve vendore dhe kjo është shumë konstruktive. Kjo na jep shpresë neve dhe shpresojmë t'i japë shpresë edhe popullit shqiptar që të shpresojë për zhvillime më të mira, për një të ardhme më të mirë.

TV Klan: Ambasadori Wollfarth, kjo është fushata e parë që ju ndiqni në Shqipëri. Duke e krahasuar me fushatat e tjera që ju keni ndjekur në Kosovë dhe në vende të tjera, çfarë mendoni për fushatën këtu?

Ambasadori Wollfarth: Pikësëpari, admiroj guximin e kandidatëve. Kur ata dalin me programe dhe i prezantojnë ato që nga viti 2009 në një mjedis mjaft dinamik, përgjithësisht e bëjnë këtë në një mënyrë shumë të mirë dhe të civilizuar dhe unë besoj se kjo vërtet duhet përgëzuar. Është shumë gjë e mirë. Shqipëria është një vend sovran që vitin e ardhshëm feston 100-vjetorin e pavarësisë, është bërë mjaft progres dhe kjo është e dukshme. Unë nuk shoh se mungon ndonjë element. Ndoshta mungon pak durimi...

TV Klan: Por vetëm një e katërta e historisë së pavarësisë sonë ka qenë histori e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Ambasadori Wollfarth: Por ju keni përparësinë se keni shumë shembuj të mirë përreth, sigurisht që varet nga i hidhni sytë. Pra, si vend, Shqipëria nuk ka pse të ketë frikë nga krahasimi në këtë moment. Çështja qëndron tek vullneti i mirë dhe ky është ndoshta një element që unë do të doja ta shihja më shumë. Vullneti i mirë politik për t'i bërë gjërat siç duhet, për t'i bërë gjërat me frymën e të ndihmuarit të demokracisë që ajo të funksionojë vërtet, për të rritur besimin dhe me dëshirën për ta hedhur çdo hap në interesin e përgjithshëm

të të pasurit të një procesit të rregullt, sidomos tani në rastin e zgjedhjeve. Kjo është vërtet diçka, ku unë, siç e kam thënë edhe më përpara, do të doja të shihja më shumë. Në Kuvend u mbajt një tavolinë e rrumbullakët, një nismë shumë e mirë për të nxitur vullnetin e mirë politik. Çfarë është vullneti politik? Vullnet politik do të thotë që kur të gjitha kampet bien dakord që t'i bëjnë gjërat siç duhet, atëherë nuk është nevoja për ligje apo rregullore shumë specifike, zhvillohet një proces i rregullt sa i takon fushatës, zhvillohet një proces i rregullt ditën e zgjedhjeve, numërimi bëhet i rregullt, dhe kemi një reagim të qytetëruar nga fituesi, që është edhe pjesa e lehtë, dhe pjesa tjetër pastaj e vështirë, humbësi pranon humbjen. E gjitha kjo ka nevojë për një vullnet të mirë dhe le të shpresojmë që ai vullnet i mirë që unë e shoh që tani do të rritet dhe që t'i bëjë këto zgjedhje shumë të mira dhe të suksesshme.

TV Klan: Por edhe pas 20 vjetëve zgjedhjesh të lira në Shqipëri, ambasador, nuk ka ndodhur kurrë në zgjedhjet e kaluara që partitë politike të kenë pranuar rezultatet. Humbësit janë ankuar çdo herë për rezultatet. Pse e kanë kaq problem? Është problemi ynë, sigurisht, por...

Ambasadori Wollfarth: Padyshim, nuk është modeli që duhet të vazhdohet të ndiqet. Pikërisht këtu do të doja që gjërat të mos vazhdonin si kanë qenë dhe rezultati të pranohet, sigurisht, pas një procesi të rregullt. Kjo është pjesë e vullnetit politik që unë sapo u përpoqa ta përshkruaja. Kur pranon rregullat e lojës, duhet t'i respektosh ato. Rregullat janë edhe në duart e zgjedhësve, sidomos në vendimin që ata marrin për ta hedhur votën e tyre në ditën e zgjedhjeve. Është e rëndësishme që vota e tyre të numërohet siç duhet, dhe pastaj, me vullnetin e mirë, të pranohet. Tani në këto zgjedhje vendore, kemi shumë zgjedhje që bëhen në të njëjtën kohë, sepse bëhen në gjithë vendin për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive dhe komunave, por zgjidhen edhe këshillat e tyre, kështu që janë të shumtë ata njerëz që do të duhet ta kenë këtë vullnet të mirë e të pranojnë rezultatet. Disa prej tyre do të rizgjidhen, disa do të zgjidhen për herë të parë, disa nuk do të rizgjidhen, dhe ata të gjithë duhet të kenë guximin, vullnetin e mirë dhe disiplinën për ta pranuar vendimin e zgjedhësve.

TV Klan: Dhe a mendoni se kjo gjë mund të ndryshojë?

Ambasadori Wollfarth: Kjo është diçka që mund të arrihet. Zgjedhjet deri tani kanë pasur ato ulje-ngritjet e tyre gjatë historisë, është e vërtetë, por këto zgjedhje vijnë pas krijimit të një regjistri të ri të gjendjes civile, një sistemi të ri adresash, pas pajisjes me karta dhe pasaporta biometrike. Pra, këto zgjedhje do të mbahen mbi baza shumë të shëndosha dhe më të sigurta. Madje, edhe kjo, meqë ra fjala, është rezultat i një pune të përbashkët, sepse nevojitej një bashkëpunim midis nivelit qendror dhe atij vendor dhe ka pasur shumë sy, nga të dyja palët, që e kanë kontrolluar këtë proces, dhe unë uroj që kjo frymë bashkëpunimi të vazhdojë. Ka pasur dëshirë për të bashkëpunuar, por siç e thashë, kjo është pjesë e vullnetit politik për t'i ndarë çështjet partiake nga çështjet me interes të përgjithshëm, për të çuar Shqipërinë përpara, për ta çuar drejt një demokracie edhe më të stabilizuar dhe drejt një vendi më të përshtatshëm për jetën e përditshme të qytetarëve të tij.

TV Klan: Ambasador Wollfarth, ne kemi pasur shumë probleme dhe diskutime midis qeverisë dhe opozitës rreth Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ata donin ta ndryshonin përbërjen e tij dhe reagimi i OSBE-së dhe i disa institucioneve të tjera ka qenë se nuk kishte kohë të mjaftueshme për ta ndryshuar KQZ-në. Mos ka qenë ky një gabim i bërë nga ju?

Ambasadori Wollfarth: E rëndësishme është që tani Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është sërish i plotë, sepse anëtarët e propozuar nga opozita që kishin ndërprerë pjesëmarrjen e tyre në Komision duke filluar nga muaji janar, tani janë rikthyer. Kjo është shumë e rëndësishme sepse rrit transparencën e vendimmarrjes dhe ne nuk mendojmë se është mirë që kali të

ndërrohet gjatë garës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një organ teknik dhe duhet të bëjë një punë teknike.

TV Klan: Ata thonë se ai është një organ politik.

Ambasadori Wollfarth: Ata janë plotësisht të lirë ta thonë këtë, por nga këndvështrimi ynë ai është një organ teknik dhe ka nevojë për kontributin e gjithë kampeve. Sipas Kodit Zgjedhor, katër anëtarët propozohen nga qeveria, tre nga opozita, dhe të gjithë punojnë për të gjetur zgjidhjet më të mira. Me Kodet e mëparshme zgjedhore ka qenë ndryshe, ka pasur një rol shumë më të fortë të Presidentit, por që t'i kthehemi situatës së sotme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është rikthyer normalitetit, në kuptimin që gjithë anëtarët e tij marrin pjesë në të. Edhe për ta sigurisht, vullneti i mirë për të bashkëpunuar dhe për të gjetur zgjidhje të mira teknike është shumë e rëndësishme dhe është çështje teknikaliteti kur vjen fjala të përmbajtja e fletëve të votimit, numri i votuesve të regjistruar në një qendër votimi, kontrolli i numrit dhe vendndodhjes së qendrave të votimit që sa herë që është e mundur qendrat të jenë në vende publike dhe kështu me radhë. Këto janë të gjithë gjëra teknike dhe kur ekziston një mjedis politik dinamik kjo sigurisht që ndikon në vendimmarrje dhe kjo është ajo që pamë dhe prandaj pati një ndërprerje prej disa javësh, kur KQZ-së iu desh të vazhdonte pa mbështetjen e anëtarëve të propozuar nga opozita. Sigurisht, është një komision i nivelit qendror, por ndoshta duhet të qartësojmë, gjithashtu, se aty nuk ka një palë të qartë qeveritare dhe një palë opozitare. Zgjedhjet që po vijnë janë zgjedhje vendore dhe kemi një përzierje. Kemi sigurisht qeveri vendore në shumë vende që nuk i përkasin patjetër të njëjtave parti politike në nivel kombëtar. Pra, kemi një tablo të përzier, dhe ata punojnë për të gjithë, pavarësisht përkatësive të tyre politike. Kjo punë teknike duhet të kryhet në një mënyrë sa më profesionale dhe për të gjithë, pa dallime. Një nga gjërat kyç në mandatin OSBE-së është që të mbështesim qeverinë, institucionet në ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe KQZ-ja, sigurisht, është një institucion shtetëror dhe si i tillë ai duhet të funksionojë në mënyrë neutrale dhe të qetë me bashkëpunimin e gjithë anëtarëve të tij në detyrë. Për fat të keq nuk e kemi parë të ndodhë kjo gjë pa ndërprerje. Tani, sërish, ky komision i është rikthyer më shumë normalitetit.

TV Klan: A keni besim te ky komision, Ambasadori Wollfarth?

Ambasadori Wollfarth: KQZ-ja, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që Shqipëria ka, është i vetmi komision për zgjedhjet, kështu që nuk ka mundësi zgjedhjeje. Ne ofrojmë këshilla, sa herë që nevojitet, për të ecur përpara me hapat teknike. Gjithçka tjetër i përket politikës, por kjo u takon qytetarëve të vendosin nëse e besojnë apo jo.

TV Klan: Problemi është se para disa ditësh ky komision bllokoi transmetimin e dy spoteve të Partisë Socialiste për dy ditë. Ishte një vendim njëpalësh nga ky këndvështrim.

Ambasadori Wollfarth: Kjo është një analizë që duhet bërë nga ekspertët. Ndoshta ka pasur ndonjë gabim, por nuk më takon mua të komentoj. Kur vjen fjala të spotet, partitë janë plotësisht të lira të dërgojnë atë që dërgojnë, por sa më shumë përmbajtje që të kenë, sa më shumë argumente të prezantohen, aq më mirë është.

TV Klan: Ambasadori Wollfarth, ju keni folur shumë herë për shoqërinë civile. A mendoni vërtet se shoqëria civile e Shqipërisë mund të marrë një përgjegjësi në këto zgjedhje?

Ambasadori Wollfarth: Po. Për shembull, për të diskutuar argumentet, sugjerimet e paraqitura në programet e kandidatëve, duke ofruar këshillat dhe opinionet e tyre për t'i ndihmuar qytetarët që të marrin një vendim. Ka shpesh edhe në media diskutime shumë të

mira publike dhe mua do të më pëlqente të kishte më shumë diskutime të tilla në të ardhmen. Përveç kandidatëve dhe partive që prezantojnë programet e tyre, do të ishte mirë që të kishim edhe opinionin e medias dhe të shoqërisë civile, madje edhe me sugjerime për zgjedhjet e ardhshme. Pra, ekziston një hapësirë shumë e rëndësishme, që këtu nuk është bosh, por që mund të mbushej në një mënyrë shumë më tepër krijuese.

TV Klan: Në Shqipëri ekziston perceptimi se shoqëria civile është e ndarë në dy pjesë, njëra që mbështet të majtën dhe tjetra të djathtën. A mendoni se kemi vërtet një shoqëri civile që mund të jetë në nivelin e partive?

Ambasadori Wollfarth: Edhe një herë, mbështetja e shoqërisë civile është pjesë e mandatit tonë, që do të thotë një diskutim shumëgjyresh, kështu që unë shpresoj që shoqëria civile në sytë e publikut të mos jetë e ndarë në dy, por në shumë pjesë, në mënyrë që të ofrojë atë diskutim të gjallë e të civilizuar duke dhënë propozime të mira për ta çuar vendin përpara në mënyra edhe më të mira. Prandaj edhe këshilla e shoqërisë civile është e nevojshme për sa kohë ajo e bën këtë në mënyrë neutrale. Këshillat, dëshirat, perceptimet, apo qoftë edhe elementë të utopisë janë shumë më të lehta për t'u dhënë nga njerëzit që nuk janë në pushtet. Në momentin që dikush merr një detyrë apo vjen në pushtet, detyra e tij është të japë rezultate. Kjo është edhe sfida dhe ky është edhe ndryshimi në momentin që një politikan zgjidhet në një detyrë. Nuk mjafton vetëm të prezantojë një program të mirë, ai apo ajo duhet të japë rezultate. Kjo lojë, para-mbrapa, këto diskutime, këto diskutime të civilizuara, janë diçka që stimulojnë gjetjen e zgjidhjeve të mira për vendin dhe meqë po u afrohemi zgjedhjeve vendore, kjo vlen edhe për bashkitë, sepse tani një zgjidhje që mund të jetë e përshtatshme për një çështje të caktuar në Korçë, mund të mos jetë po aq e përshtatshme në Elbasan, apo në Kukës apo Shkodër, kështu që ka shumë gjëra për t'u zgjidhur. Shoqëria civile ekziston në nivel kombëtar dhe në nivel vendor shpresoj. Sigurisht që në varësi të përmasave të bashkive, është më e lehtë qytete të mëdha sesa në vende të vogla.

TV Klan: Ambasador Wollfarth, cilat janë standardet ndërkombëtare për zgjedhjet? Kemi 20 vjet që diskutojmë për këto standarde ndërkombëtare dhe për çdo zgjedhje thuhet se ishin më të mira se të kaluarat, por ende pa i përmbushur plotësisht standardet ndërkombëtare. Cilat janë standardet ndërkombëtare?

Ambasadori Wollfarth: Lërmëni t'ju bëj një panoramë të shpejtë, pa hyrë shumë në teknikalitete. Po e nis nga ajo që tha ambasadori Ettore Sequi: të pasqyrohet me vërtetësi vullneti i zgjedhësve. Por kjo përfshin shumë më tepër. Sigurisht, duhet të ketë mundësi zgjedhjeje. Duhet të ketë programe të partive të ndryshme politike, kur flasim për nivelin kombëtar dhe programe të ndryshme se si të zhvillohet qyteti apo bashkia kur flasim për nivelin vendor. Mundësia e zgjedhjes është në thelb të demokracisë. Pra, nuk duhet të urdhërojmë e të na urdhërojnë për kë të votojmë dhe duhet të kemi akses të lirë. Kjo do të thotë, për shembull, që qendrat e votimit të jenë vetëm në vende publike, zgjedhësit të kenë mundësinë e zgjedhjes, të kenë mundësinë që të shkojnë personalisht për të votuar, një njeri një votë, e numëruar me vërtetësi, lista zgjedhësish të mira e të plota, askush të mos mungojë në to, të mos ketë në to emra që s'duhet të jenë aty, si dhe disa gjëra të tjera, përfshirë edhe pasja e një flete votimi të pastër. Kjo mund të jetë shumë e thjeshtë. Varet nga rregullat. Në disa vende, fleta e votimit ka cilësinë e letrës së gazetës, pra është relativisht e lirë. Procesi i numërimit duhet të jetë i mirë, transparent dhe i vërtetë, pra të fotografohet kështu vullneti i zgjedhësve që kanë mundësi zgjedhjeje dhe akses të lirë. Kaq e thjeshtë është. Dikush mund ta vërë në një Kod të thjeshtë, një tjetër në një Kod të ndërlikuar. Disa vende, që janë anëtare të Bashkimit Evropian, kanë kode zgjedhore mjaft të shkurtra, pra është kryesisht vullneti i mirë i vullnetarëve të vërtetë që vijnë nga partitë për ta bërë këtë shërbim ndaj qytetarëve, duke qenë të pranishëm në qendrat e votimit, duke qenë të pranishëm gjatë procedurave të

numërimit dhe duke e bërë këtë me vërtetësi, me ndershmëri dhe me atë vullnetin e mirë, të cilin e përmenda kaq shpesh. Ky, pra, është standardi ndërkombëtar. Sigurisht, në jetën reale, meqë është proces pune, këtu në Shqipëri, por jo vetëm këtu, çdo listë që përgatitet ka nevojë të rishikohet. Dhe kur kjo listë përmban miliona njerëz, rishikimi duhet të jetë i vazhdueshëm. Prandaj ka ndryshim mes listave paraprake dhe atyre përfundimtare dhe, nëse dikush ndërron vendbanim më vonë, duke iu drejtuar një gjykatësi, ai mund të vihet në listë madje deri gjashtë orë përpara mbylljes së qendrës së votimit. Pra është një proces pune në vijimësi, por ai duhet të jetë transparent, i lirë dhe të ofrojë mundësi zgjedhjeje. Ky është standardi ndërkombëtar. Nuk ka asgjë mistike rreth tij, nuk është sekret, nuk është magji. Është thjesht liria e zgjedhjes dhe vënia e saj në jetë.

TV Klan: Është shumë e vështirë.

Ambasadori Wollfarth: Dhe nuk duhen ndihmuar njerëzit që të hedhin votën e tyre edhe kur nuk janë të pranishëm, duke mbushur kutitë me fletë votimi, siç kemi dëgjuar se ka ndodhur më parë dhe siç shpresoj që të mos e dëgjojmë më, apo votimi familjar dhe gjithë këto gjëra të shëmtuara. Ky nuk është diçka që duhet inkurajuar, sepse për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare duhet që çdo person të hedhë vetëm një votë.

TV Klan: Por unë besoj se ky problemi i votimit familjar duhet të jetë shumë i vështirë për t'u zgjidhur. Më duket se edhe në Italinë e Jugut ka qenë karakteristike për një kohë të gjatë. A mendoni se mund të gjejmë vërtet një zgjidhje për këtë lloj votimi? Nuk është karakteristikë e zonave urbane, por në zonat rurale sidomos.

Ambasadori Wollfarth: Nuk dua të tingëlloj qesharak, por është thjesht diçka që nuk duhet bërë. Një rol në të kanë edhe vetë qytetarët. Që të lësh dikë të votojë për ty, nuk do të thotë t'i delegosh atij personi ndershmërinë apo vërtetësinë. Duhet që çdo votues të jetë i vërtetë. Vetë qytetarët, edhe në familje, thjesht nuk duhet t'i pranojnë këto praktika. Në qoftë se nuk ka njerëz që tentojnë ta bëjnë këtë, as njerëzve në qendrat e votimit nuk do të kenë nevojë ta kontrollojnë këtë proces. Ata mund të fokusohen në gjëra të tjera, si në kontrollin e kartave të identitetit, kontrollin e listës së zgjedhësve, që çdo votues të hedhë vetëm një votë. Kjo është mënyra se si duhet të bëhen gjërat, por kjo kërkon vullnet të mirë dhe fillon nga vetë njerëzit. Është si siguria, për të cilën folëm më parë. Kjo nuk është vetëm detyrë e policisë. Në kushte ideale, Policia është aty, është e pranishme, si një lloj konvertuesi katalizues për një proces më të mirë dhe kur qytetarët sillen siç duhen, sigurisht që nuk ka nevojë për polici, por ndoshta njerëzit mund të sillen më mirë për shkak se policia është e pranishme dhe merr masa kur është nevoja. Por gjithçka fillon me vullnetin e mirë të njerëzve, i cili nevojitet gjatë gjithë procesit dhe kjo vlen jo vetëm jo vetëm për zgjedhjet por edhe për mënyrën se si funksionon shoqëria. Fillon me sjellje të mirë, me respektimin e ligjit, dhe sidomos në ditën e zgjedhjeve.

TV Klan: Por a mendoni se ky Kod do të garantojë standardet ndërkombëtare për Shqipërinë?

Ambasadori Wollfarth: Po, mund t'i garantojë. Kodi aktual fokusohet më shumë te zgjedhjet e përgjithshme dhe do të ishte mirë që të ardhmen të shtoheshin, me marrëveshje reciproke, edhe disa dispozita specifike për zgjedhjet vendore që nuk ekzistojnë ende. Megjithatë, Kodi Zgjedhor, kështu siç është, është mjaftueshëm i mirë për të siguruar arritjen e standardeve ndërkombëtare.

TV Klan: Deri tani, Ambasadori Wollfarth, në zgjedhjet e kaluara, me përjashtim të atyre të 96-ës, të cilat ishin katastrofë, ne nuk i kemi pasur problemet para ditës së zgjedhjeve. Ato janë shfaqur vetëm kur ka filluar numërimi i fletëve të votimit apo kur

njërës palë i është dashur të pranojë se i ka humbur zgjedhjet. Çfarë mendoni se duhet të bëjmë që të mos gjendemi në të njëjtën situatë?

Ambasadori Wollfarth: Proces i rregullt, numërim i rregullt, dhe pranim rezultatesh.

TV Klan: Pranim rezultatesh... A duhet të jetë e lehtë?

Ambasadori Wollfarth: Duhet të jetë gjëja më e lehtë në botë, sepse kjo do të thotë të respektosh zërin e votuesve.

TV Klan: Kush do ta japë certifikatën e zgjedhjeve?

Ambasadori Wollfarth: Populli shqiptar. Institucionet shqiptare. Ajo që bëjmë ne ndërkombëtarët dhe sidomos ODIHR-i, është vëzhgimi i këtij procesi shqiptar. Këto janë zgjedhje shqiptare për rreth 384 njësi, për kryetarë bashkie dhe komune dhe për anëtarë këshillash. Zgjedhjet certifikohen nga shqiptarët që janë pjesë e komisioneve të administrimit të zgjedhjeve, janë Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve ato që certifikojnë procesin si të rregullt, ndërkohë që ODIHR-i dhe të tjerë i vëzhgojnë dhe, në fund, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i përbërë nga shtatë anëtarë, bën një kontroll të dytë. Kjo është shkalla e parë dhe nëse ka ndonjë dyshim, palët mund të ankohen, siç kanë bërë disa herë në të kaluarën, por ashtu siç edhe nuk e kanë bërë në raste të tjera, kur janë mjaftuar vetëm duke folur për to. Pra ka dispozita ligjore që mund të përdoren nëse është e nevojshme.

TV Klan: Ambasador, sa vëzhgues do të kemi për zgjedhje.

Ambasadori Wollfarth: Mund t'ju them se sa mund të ofrojmë si OSBE/ODIHR. Bëhet fjalë për afërsisht 500 vëzhgues.

TV Klan: 500 vëzhgues?

Ambasadori Wollfarth: 500 vëzhgues, por nuk mund t'ju them shifrën e plotë, sepse mund të vijnë për këtë qëllim edhe parlamentarë të ndryshëm nga një sërë vendesh dhe mesa kuptoj edhe institucione të tjera si këshilli i Evropës kanë ndër mend të dërgojnë vëzhgues të tjerë, por nuk kam ndonjë shifër të konfirmuar ende. Por ekziston një interes i madh, që duhet të shihet edhe si një shenjë e madhe solidariteti për popullin shqiptar, duke i ndihmuar por tashmë në një rol të reduktuar, si një lloj konvertuesi katalizues, ndërkohë që zgjedhjet janë një proces tërësisht shqiptar, duke ndihmuar për një ditë vërtet të mirë zgjedhjesh dhe një periudhë konstruktive pas tyre. Ne kemi edhe një mbështetje të madhe. ODIHR-i, si e gjithë puna jonë, ka mbështetjen e gjithë vendeve anëtare të OSBE-së, duke përfshirë SHBA-të, madje duke përfshirë edhe vetë Shqipërinë, meqenëse edhe Shqipëria është një vend anëtar i OSBE-së

TV Klan: Ambasador Wollfarth, kur do të dalë deklarata e parë e ODIHR-it për zgjedhjet?

Ambasadori Wollfarth: Duke pasur parasysh se procesi i decentralizuar i numërimit mund të jetë i gjatë, me shumë gjasa, ODIHR-i nuk do ta bëjë deklaratën e parë më 9 maj. Z. Jonathan Stonestreet, i cili kryeson misionin e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve ka menduar që ndoshta deklarata të bëhet të martën, dy ditë pas ditës së zgjedhjeve.

TV Klan: A s'është tepër vonë?

Ambasadori Wollfarth: Siç thashë, varet nga shpejtësia e numërimit të votave. Është e logjikshme, pasi do të duhen të numërohen 384 shumëzim për 2 fletë votimi – për kryetarin e bashkisë ose komunës dhe këshillin. Rrjedhimisht, do të duhet kohë, si për daljen e rezultateve ashtu edhe për vëzhgimin gjatë procesit të numërimit dhe vetëm kështu përshtypja e parë që do të jepet do të jetë e saktë. Ky do të jetë vetëm hapi i parë, pasi më vonë, disa javë

më pas, misioni ODIHR-i do të nxjerrë raportin e vëzhgimeve të veta gjatë fushatës, ditës së zgjedhjeve, procesit të numërimit dhe pas ditës së zgjedhjeve. Pra, nuk është diçka që duhet bërë me nxitim. Kjo gjë, patjetër kërkon kohën e duhur dhe dy ditë nuk janë shumë, duke pasur parasysh numrin e votave, madje mendoj se është shpejt.

TV Klan: Ambasador Wollfarth, gjatë 2-3 zgjedhjeve të kaluara kemi pasur problemin e madh të standardit të lajmeve të përgatitura nga partitë dhe jo nga media. Cili është mendimi juaj për këtë?

Ambasadori Wollfarth: Media duhet të raportojë e lirë dhe të ofrojë gazetari të mirë. Kjo do të thotë që të paktën, të kenë mundësi të ndjekin një pjesë të veprimtarive për të filmuar dhe për t'u dhënë fakte teleshikuesve. Më tej, ata mund të shtojnë edhe komente, duke i etiketuar ato si të tilla. Nuk është gazetari e mirë kur këto përzihen dhe teleshikuesi nuk e ka të qartë se nga vjen kronika. Gazetari e mirë është kur gazetari ka vetë akses direkt dhe përgatit një raport të plotë e profesional. Kjo është shumë më mirë se sa kasetat e gatshme, pasi, ndonjëherë, këto të fundit janë vetëm një hap larg propagandës partiake. Propaganda partiake nuk ka asgjë të keqe në vetvete, për sa kohë që teleshikuesi e kupton që është reklamë dhe propagandë. Edhe kjo është plotësisht e pranueshme, është dhe duhet të jetë pjesë e fushatës, por nuk duhet të ngatërrohen. Puna profesioniste e gazetarëve duhet të jetë qartësisht e ndarë nga reklama dhe kur kjo ofrohet, votuesi, qytetari, individi që e sheh ka mundësinë që të vendosë vetë.

TV Klan: Ambasador Wollfarth, ç'mendim keni për dy liderët? E di që është gjithmonë e vështirë të flasësh për liderë, por...

Ambasadori Wollfarth: Në mënyrë absolute, të dy, si kryeministri Berisha, ashtu edhe kryetari i Bashkisë Rama janë liderët e partive të tyre. Janë karizmatikë dhe në disa raste kemi pasur diskutime dhe shkëmbim idesh interesante, kryesisht drejt së ardhmes. Të dy kanë shqetësimin që t'u shërbejnë qytetarëve dhe të dy, e theksoj të dy, janë të vendosur për të luftuar korrupsionin, si dhe për të rritur më tej shkallën e ndershmërisë. Siç e thashë edhe në një veprimtari kundër korrupsionit dje paradite, asnjë shtet nuk është plotësisht i çliruar nga korrupsioni. Është një punë në vijimësi, që ka nevojë për të gjitha palët, në të gjitha nivelet. Të dy e kanë në vëmendje këtë çështje dhe kjo është shumë e rëndësishme. Ata ofrojnë alternativa, qoftë njëra ngjyrë apo tjetra. Kjo është shumë e rëndësishme. Duke u dhënë këtë ofertë qytetarëve, i shërben shoqërisë. Unë do të doja të shihja më shumë bashkëpunim. Hapi i parë i takon padyshim kryeministrit Berisha për shkak se është kryetar i qeverisë dhe duhet të bëjë më shumë përpara drejt opozitës dhe të bëjë ofertën për një dialog të mirëfilltë për çështjet e rëndësishme, në mënyrë që vendi të ecë përpara. Njëkohësisht, nga opozita do të prisja më shumë hapa konstruktivë. Unë shoh drejt së ardhmes dhe nuk dua më të shoh veprime të tilla si bojkotet dhe grevat. Këto u përsëritën në vendet fqinje dhe nuk po çojnë askund. E rëndësishme është që liderët ta udhëheqin Shqipërinë drejt së ardhmes dhe, këtu, unë pres më shumë disiplinë. Më pak blu, më pak të kuqe, më shumë Shqipëri. Në këtë pikë, shoh qartësisht mungesa. Kjo është natyrisht skema e madhe kombëtare. Tani po u drejtohem zgjedhjeve vendore. 8 Maji është një ditë me më shumë rrezik për kandidatin Ramën, sesa për kryeministrin Berisha.

TV Klan: Pse?

Ambasadori Wollfarth: Sepse nuk është dita e zgjedhjeve për kryeministrin. Kështu që, duhet të rifokusohemi. Megjithëse janë të dy kryetarë të partive kryesore, ata kanë detyra të ndryshme dhe është sigurisht detyrë e lartë të administrosh Tiranën. Zoti Rama është rizgjedhur disa herë. Pra në të shkuarën, duket se ka pasur një nivel të lartë besimi te puna e tij. Tani e kanë në dorë votuesit. E njëjta gjë vlen edhe për kryeministrin Berisha dhe

qeverinë e kryesuar prej tij kur një ditë të zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe njerëzit të tregojnë nëse kanë besim te ta. Tani duhet të përqendrohemi te zgjedhjet. Është një ditë shumë e rëndësishme, sepse do të vendoset, në nivel vendor, në të gjitha qytetet e komunat se si administrohet jeta e përditshme nga kryetarët e bashkive dhe komunave dhe këshillat bashkiakë. Prandaj, ka shumë për të rrezikuar dhe, nëse mund të shtoj edhe një dëshirë, kjo pjesë shërbimesh duhet ndarë nga gara mes partive.

TV Klan: Ambasador Wollfarth, çfarë do të bëni personalisht ditën e zgjedhjeve. Do të rrini në Tiranë apo do të udhëtoni?

Ambasadori Wollfarth: Një gjë është e sigurt, do të jem në Shqipëri. Nuk e kam vendosur përfundimisht se ku do të jem atë ditë. Kryeqyteti është gjithmonë më tërheqësi, prandaj ka shumë gjasa që ta kaloj këtu ditën, por, të jem i sigurt, s'e kam vendosur akoma.

TV Klan: Pyetja e fundit për ju, duke filluar nga ambasadori Wollfarth. Cili është mesazhi që keni për zgjedhësit shqiptarë për 8 Majin?

Ambasadori Wollfarth: Shkoni dhe votoni. Bëni zgjedhjen tuaj. Kini besim që zëri juaj, vota juaj ka vlerë dhe numërohet me vërtetësi. Shikoni drejt së ardhmes, jepni kontributin tuaj, por, së pari, shkoni të votoni.

Fund